

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj, kryetar dhe Fejzullah Rexhepi e Isa Shala, në çështjen kontestimore të paditësit N.H Ibër Lepenci, të cilën e përfaqëson N.H., kundër të paditurit F.A. nga M., objekti i kontestit pagesa e borxhit, duke vendosur sipas ankesës së paditurit e paraqitur, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr 2853/11 të dt. 26.06.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 24.11.2016, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Më miratimin e pjesërishëm të ankesës së të paditurit, NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr 2853/11 i dt. 26.06.2014, në pjesën e dispozitivit sa i përket kamatës së gjykuar dhe gjykohet: me kamatë e cila vlen si për mjetet e deponuara në bankat që operojnë në Kosovë, në afat më tepër se 1 (një) vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimit në shkallë të parë prej dt.26.06.2014 e deri te pagesa e plotë, ndërsa sa i përket pjesës tjetër të dispozitivit REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr 2853/11 të dt. 26.06.2014, VËRTETOHET.

## A r s y e t i m

### **Historiku procedural:**

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.H Ibër Lepenci nga Prishtina dhe është detyruar i padituri F.A. nga ... që paditësit, në emër të shfrytëzimit të sistemit të ujitjes t'ia paguaj borxhin, në shumën prej 420 € dhe me kamatë ditore prej 0.08 %, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 15 €.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur pala e paditur, pa i cekur shkaqet, me propozim që gjykata e shkallës së dytë të marr një vendim të drejtë.

### **Gjetjet e Gjykatës së Apelit**

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 të LPK, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me padi ka kërkuar që të detyrohet i padituri që në emër të shfrytëzimit të sistemit të ujitjes t'ia paguaj paditësit borxhin, në shumën prej 420 € dhe me kamatë ditore prej 0.08 %, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 15 €, si dhe i ka propozuar gjykatës së kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar. Pala paditëse në padi ka theksuar se i padituri e ka shfrytëzuar sistemin e ujitjes për ujitjen e sipërfaqes prej 3.5 ha, por që i ka mbetur borxh paditëses shumën prej 420.00 €.

Pala e paditur e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit duke theksuar se nuk është kundër pagesës por që shuma me të cilën ngarkohet, nuk i takon atij që të paguaj, për arsye se posedon gypat e tij për ujitje. Gjykata e shkallës së parë në vendimin e saj ka theksuar se aktgjykimin e saj i ka mbështetur në të dhënat si nga procesverbali nr. 04-390 i dt. 18.10.2010 i cili gjendet në shkresat e lëndës që është i nënshkruar edhe nga vetë i padituri, pastaj nga kartela e konsumatorit në të cilën është e cekur vlera e borxhit të theksuar, si dhe dëgjimi i dëshmitarit M.P, i cili ka sqaruar se i padituri ka deklaruar se çmimi i ujitjes për vitin 2010 ka qenë në shumën 100 € për hektar, për personat të cilët e kanë nënshkruar kontratën për ujitje, kurse 120 €, për personat të cilët e kanë shfrytëzuar ujin pa kontratë. Dëshmitari ka theksuar se procesverbali mbi shfrytëzimin e ujit për ujitje nga ane e të paditurit, me nr. 04-390 i dt. 18.10.2010, është nënshkruar nga ai vetë, dhe i padituri.

Nga shkresat e lëndës, gjithashtu rezulton se gjykata e shkallës së parë ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që ka obliguar të paditurin, që në emër të borxhit, t'ia paguaj paditësit shumën prej 420 €, dhe me kamatë ditore prej 0.08%, si dhe shpenzimet e procedurës, në shumën prej 15 €.

### **Baza ligjore:**

Neni 194 i LPK: “ Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji”.

Neni 195.1 i LPK “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj: .....d) ta refuzojë ankesën si të pa themeltë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e goditur “.

Neni 195.1 i LPK: “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj: .....e) ta ndryshojë aktgjykimin e goditur “.

### **Vlerësimi i Gjykatës:**

Nisur nga gjendja e vërtetuar faktike Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të paditurit, janë të pa themelta dhe vlerëson se gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të provave të administruara të ofruara nga palët ndërgjyqës, ka marrë aktgjykimin i cili sipas

vlerësimit të Kolegjit të Gjykatës së Apelit është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye konkrete edhe për faktet vendimtare duke dhënë shpjegimet dhe arsyet adekuate për një vendosje të këtillë bazuar në dispozitat përkatëse ligjore që i referohen kësaj çështje kontestuese.

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të ligjshëm e miraton në tërësi edhe ky kolegji, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe se me rastin konkret është bërë zbatimi i të drejtës materiale në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Sipas vlerësimit të kolegjit gjykata e shkallës së parë drejtë i ka zbatuar dispozitat materiale kur ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit duhet të aprovohet në tërësi.

Kolegji i gjykatës së shkallës së dytë, vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të parashtruara nga ana e palës së paditur, pasi që gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë, se ekziston detyrimi i të paditurit, i njëjti ka bërë shfrytëzimin e ujit për ujitje, mënyra e caktimit të lartësisë së borxhit është sqaruar në mënyrë të plotë gjatë procedurës së zhvilluar para gjykatës së shkallës së parë, dhe se i padituri ka për obligim t'ia paguaj borxhin paditësit, në shumën si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar me ankesë.

Ndërkaq, sa i përket kamatës, gjykata e shkallës së dytë Aktgjykimin e atakuar e ka ndryshuar në pjesën e dispozitivit e cila ka të bëjë me kamatën duke gjykuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, pasi që në rastin konkret kamata caktohet me kamatë e cila vlen si për mjetet e deponuara në bankat që operojnë në Kosovë, në afat më tepër se 1 (një) vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimit në shkallë të parë prej dt.26.06.2014 e deri te pagesa e plotë, në kuptim të dispozitave të nenit 277 të LMD i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të detyrimit.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura, e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika d) dhe e) të LPK, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.4874/14 me dt.24.11.2016

Kryetari i Kolegjit - Gjykatësi,  
Dr.sc. Rafet Haxhaj